



Pranuar / Dorezuar Prilimno / Protokolo Received / Delivered	11	11	2020	0	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKANBETEK	2555/2020		113		



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.298/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.298/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████, me adres rruga "Fazli Gashi", në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 11.11.2020, mori këtë:

### V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.298/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

### A r s y e t i m

Ankuesi ██████████ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 30.09.2011 në pozitën e punës "Vozitës" në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, më datë 09.03.2020 ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin e koeficientit të pagës në Divizionin për Burime Njerëzore, ndërsa me datë 05.08.2020, për të njëjtën çështje ka parashtruar kërkesë të U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.

Ankuesi, meqenëse nuk ka marr përgjigje nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, më datë 13.10.2020 ka parashtruar ankesën me Nr. Prot:2066/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 22.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Më datë 29.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 13.10.2020 me Nr.Prot:2066/2020 e parashtruar nga ankuesi ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës: Kërkesën për përgjigje ne ankese me numër te protokollit 2210/2020 te datës 22.10.2020: Akt Emërimit e datës 30.09.2011 i [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. Kërkesa per shqyrtimin e koeficientit me numër 1021 të datës 05.08.2020: Përgjigja rreth kërkesës me numër 592 e datës 23.06.2020: Kërkesa për shqyrtimin e koeficientit me numër 375 e datës 09.03.2020: Akt Emërimit e datës 07.08.2012 i Ejup Halili: Akt Emërimit e datës 03.03.2014 i Kadri Mehmeti: Ndryshim dhe Plotësim i Aktit të Emërimit i datës 12.02.2015 për Faik Ibriqi: Aktvendim me numër te protokollit 3508 i datës 18.05.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë: Përgjigja ne ankese me numër te protokollit 2355/2020 e datës 29,102020: Autorizimin për shpalljen e konkursit publik me numër te protokollit 2751 i datës 22/05/2013: Kërkesë për aprovimin e nisjes së rekrutimit me numër te protokollit 1038 e datës 16.05.2013: Form.MAP-SHCK-01 Kërkesa për Fillimin e Rekrutimit: Miratimi i titujve të ri të punës për Ministrinë e Energjisë dhe Minierave i datës 04.02.2005: Akt Emërimit e datës 15.03.2012 i Artin Loxha: Lista e pagave për vitin 2011,2012,2013,2014,2015,2016,2017,2018,2019, dhe 2020,: Akt Emërimit i datës 15.03.2012 i Ismail Nreci: Akt Emërimit i datës 23.07.2013 i Adnan Koca: Akt Emërimit i datës 15.03.2012 i Pleurat Nuza: Akt Emërimit i datës 15.03.2012 i Shenol Hacikurtesh: Akt Emërimit i datës 21.08.2012 i Adnan Ahmeti:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR], sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke iu referuar provave të lëndës respektivisht Akt Emërimit të datës 30.09.2011, konstaton se ankuesi mban pozitën e punës "Vozitës" në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 6 përcakton se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.* Andaj, duke marr parasysh se ankuesi mban pozitën e Vozitësit, Kolegji vlerëson se i njëjti ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, dhe si rrjedhoje, vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status administrativo-teknik dhe mbështetës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës të ankuesit, përkatësisht neni 4 paragrafi 4 ka përjashtuar personelin mbështetës nga Shërbimi Civil, duke përcaktuar se: *Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë,* dhe si rrjedhoje Ministria e Administratës Publike me datë 08.12.2014 ka nxjerr Qarkoren Administrative, e cila ka përcaktuar se pozita e vozitësit hynë në

kuadër të pozitive të punës me funksione mbështetës, dhe ka udhëzuar institucionet publike që marrëdhënia e tyre e punës të rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës.

Bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në ninin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe ninin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur në ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht ninin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.298/2020, datë 11.11.2020**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

**Procesmbajtëse**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit ██████████;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.